

## Editorial

**Ky numër i buletinit ka në fokus vizionimin.** Një vizion afatgjatë i së ardhmes së qytetit është element kryesor në planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Ngjashëm me moton e programit "Së bashku Bëjmë Qytete më të Mira", një vizion 'më i mirë' ka të bëjë me bërjen së bashku të Vizionit. Vizioni nuk është vetëm një ëndërr e ardhshme, por një perspektivë afatgjatë e cila merr parasysh vlerat e komunës, mundësitë duke mos i injoruar edhe problemet dhe sfidat e saj. Dhe natyrisht, ëndërimi është pjesë e tij gjithashtu.



Këto aspekte janë dëshmuar nga pjesëmarrës nga komunat tona partnere. Artikujt nga Kryeshefat e Ekzekutivit, planerët dhe përfaqësues të shoqërisë civile janë kontribut domethënës që reflekton këndvështrimet e ndryshme të eksperiencës nga punëtoritë katër ditore të vizionimit. Një veçori e veçantë është pjesëmarrja e qytetarëve përmes Këshillit Joformal të shoqërisë civile, e themeluar si pjesë e procesit të planifikimit. Ne falenderojmë të gjithë autorët për kontributet e tyre të çmueshme. Plani Zhvillimor i Komunës së Pejës

është plani i parë i aprovuar në Kosovë. Ky është një moment shumë i rëndësishëm. Peja gjithashtu ka krijuar një vizion afatgjatë, i cili është inkorporuar në plan. Megjithatë, plani nuk është fundi i procesit. Është pikërisht planifikimi (për zbatim) që ka rëndësi, më shumë se plani. Njerëzit janë faktor i rëndësishëm në planifikim dhe katalizatorë ose zbatues të ndryshimeve dhe zhvillimeve. Vullneti dhe mbështetja politike janë esenciale për t'i bërë ndryshimet të ndodhin.

Përderisa aktivitete të ndryshme joformale të mësimi dhe shkëmbimit të përvojave janë inicuar në mes komunave duke dëshmuar guxim, ky botim ofron një pasqyrë të një forumi të tillë formal siq është Konferenca mbarë - Kosovare mbi Gjendjen e Tanishme të Planeve Zhvillimore Komunale dhe Urbane.



Gjatë kohës kur po shkruajmë, BE ka adoptuar të ashtuquajturën 'Karta e Leipzig-it'. Për herë të parë, ministrat e Këshillit Joformal të Ministrive të Zhvillimeve Urbane dhe Kohezionit Territorial kanë nënshkruar tekstin i cili formulon principet e zhvillimit urban. Kjo shkon

në përputhje me qeverisjen e re e cila përafrohet me shumë akterët lokalë. Fjala kyçe është 'planifikimi i integruar'. Ne do të diskutojmë më shumë në këtë temë në numrat e ardhshëm.



Gjithashtu së fundi UN-HABITAT-i dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Transport Publik (ANTP), kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi. Të dy organizatat kanë për qëllim fuqizimin e bashkëpunimit për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm urban për zonat urbane në përgjithësi si dhe transportin publik në veçanti. Përveç kësaj, Këshilli Drejtues i 21të i UN-HABITAT-it përpiloi rezoluta të ndryshme duke reflektuar kështu mbështetjen më të madhe për përfshirjen e të rinjve urbanë në zhvillimin dhe fuqizimin e autoriteteve lokale si dhe në mes tjerash decentralizimin.

Shpresoj se ky buletin do të inspirojë të gjitha komunat e Kosovës për të avancuar ngjarjet e vizionimit, në të dy format, formale dhe joformale dhe të bëhet pjesë integruese e procesit zhvillimor komunal.

**Elisabeth Belpaire,**  
KKT/Udhëheqëse e Programit

## PEJA ME PLAN ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK) DHE PLAN ZHVILLIMOR URBAN (PZHU)

Më 14 maj 2007, Kuvendi Komunal i Pejës miratoi PZHK dhe PZHU për vitet 2006 -2025.

Në Kuvendin Komunal, u tha se këto plane kanë rëndësi jetike për zhvillimin e komunës si në zhvillimin ekonomik ashtu edhe në ruajtjen e ambientit dhe vlerave kulturo-historike.

Planet e cekura më parë, kanë marrë pëlqimin e Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe janë vlerësuar se janë në harmoni të plotë edhe me Planin Hapësinor të Kosovës.

Më këtë rast, kryetari i Kuvendit Ali Lajçi, uroi Drejtoratin për Planifikim Urban, Rural dhe Ambient dhe të gjithë pjesë-

marrësit që kontribuan në përfundimin e suksesshëm të këtyre planeve, duke theksuar së Peja, **është komuna e parë që ka realizuar me sukses këto plane zhvillimore dhe do të jetë model për komunat tjera të Kosovës.**

Burimi: [www.peja-komuna.org](http://www.peja-komuna.org)

# QYTETI KA NEVOJË PËR VIZION

Qytet tolerant, modern, me prosperitet; qytet i pastërt dhe i gjelbërt, qytet me qasje në lum që ofron mundësi për edukim, zhvillim ekonomik e kulturor me një mjedis atraktiv për të gjithë.

Vend atraktiv me zhvillim dinamik; Terminal rajonal; Qytet i hapur me perspektivë; Urë e komunikimeve ekonomike, tregtare dhe kulturore; Portë për vargmalet, aty ku bifurkacioni fton për rekreacion; Qytet integruar në mes kryeqytetesh; Vend ku promovohet potenciali investues i qytetarëve, ku jetohet denjësisht në mjedis ekologjik.

Këto janë shkurtimisht deklaratat e vizionit për Mitrovicën (Veriun dhe Jugun) si dhe Ferizajn, të përpiluara nga përfaqësues të shoqërisë civile në bashkëpunim me planerët komunalë.

Vizionimi është një aktivitet që përaftron qytetarët dhe pjesëmarrësit për të formësuar një vizion për të ardhmen e bashkësisë së tyre (komunës, qytetit, qytezës apo fshatit). Qëllimi i vizionimit është të nxirren deklaratat të shkruara dhe vizuale të qëllimeve afatgjata dhe synimeve strategjike për planifikim urban dhe hapësinor të qëndrueshëm.

Përmes fletushkës "Vizionimi i qytetit tuaj", ne dëshirojmë të promovojmë konceptin e Vizionimit si element thelbësor në proceset e planifikimit përfshirës hapësinor lokal që zbatohet në të gjitha komunat e Kosovës. Ne gjithashtu duam që teorinë t'i zbatohet



jmë në veprime dhe praktikë. Deri tani UN-HABITAT/ MuSPP ka organizuar 4 punëtori të vizionimit, së bashku me komunat OJQ lokale dhe këshillin joformal të shoqërisë civile. Komunat pjesëmarrëse: Mitrovica, Ferizaj, Gjilan e Prizreni, përdorën punëtoritë si një mundësi për të bashkërenduar veprimet si dhe definuar vizionin e zhvillimit lokal në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Punëtoritë ofruan mundësi trajnimi për pjesëmarrës, si dhe një platformë për të krijuar besimin. Ato gjithashtu ndihmuan në zgjerimin e horizontit të njohurive për pjesëmarrësit. Punëtoritë kishin një strukturë të ngjashme. Të gjitha punëtoritë patën për qëllim dhe arritën sukses që të sjellin së bashku për-

faqësues të shoqërisë civile dhe të qeverisë. Megjithatë qasjet, të arriturat dhe rezultatet ishin të ndryshme. Ato reflektuan kontekstin specifik të planifikimit komunal si dhe atë politik, gjendjen e procesit të planifikimit, mjedisin e favorshëm, pjesëmarrësit si dhe sinqeritetin e akterëve të ndryshëm të përfshirë në këto punëtori. Synimi i përbashkët i pjesëmarrësve që të "dorëzojnë" vizionin e tyre tek vendimmarrësit ishte elementi i përbashkët i të gjitha punëtorive. Është me rëndësi të theksohet se zhvillimi i vizionit dhe dorëzimi i tij tek vendimmarrësit, zhvillon dhe fuqizon shoqërinë civile duke i dhënë atyre ndjenjën e pronësisë së atij vizioni.

Pas hartimit të vizionit, ka nevojë për një debat publik dhe komunikim të suksesshëm për të marrë përkrahimin e gjerë të gjithë komunitetit. Kështu, vizioni duhet publikuar gjerësisht dhe duhet mbajtur gjallë atë. Mëtutjue monitorimi dhe raportimi i rregullt i të arriturave për publikun, është esencial për transformimin e vizionit në realitet. Vizioni i qytetit nuk është statik, por duhet shqyrtuar ose edhe zëvendësuar me një vizion të ri, kurdo që rrethanat në planifikim të kenë ndryshuar thelbësisht.

Vizionimi është punë në progres, për të vazhduar me tutje në dy MuSPP komunat tjera; e shpresojmë edhe në gjithë Kosovën.

### Ekipi i MuSPP-it



*Përshtypje nga punëtorja e vizionimit për Ferizajn*

## FLUTURIMI NË TË ARDHMEN E NJË QYTETI

*Ne do të ishim të kënaqur nëse kemi arritë të krijojmë një parafytyrim më shumë për qytetin tonë, do të ishim të lumtur poqese ai parafytyrim nesër bëhet pjesë e identitetit të Ferizajt të ri.*

Për tri ditë të qëndrimit në Ohër, mbase kemi qenë banorët e tij më të çudishëm. Derisa ohrianët bënin përditshmërinë e tyre të zakonshme buzë liqenit, ne, një grup ferizajasish kishim fluturuar në të ardhmen e qytetit tonë duke thurrur vizione për të. Duhej të ishim pelikanë të mirë për të përmbushur atë hapësirë imagjinare që u hap para nesh. E dinim se nuk e kishim lehtë aq më parë se na ndiqnin fjalët ndëshkuese të formës se "pse bash ju po shkoni në Ohër", apo "shih, shih doni të bëheni edhe arkitektë".

Por ne e thyem akullin, e hapëm librin e kujtimeve për qytetin, skutave të harrësës kujtoheshin parqet, bazenet e dikurshme, Ura e hekurit. Filluam t'i identifikojmë shenjat dalluese, bifurkacionin e lumit e vendosëm në qendër, pas degëzimeve të tij e ndiqnim kryqëzimin e rrugëve për të paraparë edhe një terminal. Fjalët produktiv, ekologjik, mobil, modern, margaritar, i artë, i gjelbërt... mbizotëronin mendimet tona duke dashur të krijojmë identitetin e tij. Vizionet tona i përngjanin mjegullës së liqenit në mëngjeset e hershme. Vinin të vullshme, emocionale dhe ndonjëherë naive.

Nga larg çfarë nuk i bënim qytetit, e zgjeronim, e pastronim, i ndërtonim lagje të reja, e bënim me liqë, me zona industriale, qendër rekreative, sportive dhe kulturore e shpallnim port malesh, urë të shumë brigjeve, e futnim hekurudhën nën tokë me një fjalë i krijonim frymëmarrje të re urbane...

Nëpër harta gjithsecili prej nesh vizatonte nga një pjesë të së ardhmes. Vështrimi hapësinor për qytetin duhej të përmbylej në disa vija që nuk i bënim drejt. Si të vonuar në kohë dhe hapësirë përjetonim ndjenjën e krijimit të hartave, të qyteteve, diçka tepër futuriste. Në të vertetë ne ishim bërë pjesë e një planifikimi, pjesë e një koncepti bashkëkohor për të qenë qytetari



pjesëmarrës i ndërtimit dhe planifikimit të qytetit të tij. "Bashkë bëjmë qytete më të mira" është motoja e këtij koncepti e promovuar nga programi i UN-HABITAT-it.

Ide pas ideje, formësoheshin dëshirat tona për qytetin. Si qytet në mes dy kryeqyteteve atij i dëshironim të kishte një sharm tjetër prej këtij që e ka sot, donim që ai të ishte embleme e artë në Fushën e Kosovës. Ashtu si të dashuruarit që mundohen të vizatojnë portretin e personit të dashur, ne bëmë portretin e qytetit tonë. Kishte ditë që ishim larg tij, por me t'u kthyer na kapluan ndjenjat e një pendese se mos e kishim tepruar me vizionet tona.

Qyteti na u shfaq i ngrysur si me një qortim se ne i kishim "pre" robe të reja shumë të gjëra. Në të vertetë edhe ai neve na u duk si tepër i pluhurosur, i ngushtë dhe i zhurmshëm. Pas disa ditë i bëmë publike vizionet tona, ato mbuluan qytetin si re të panjohura. Diçkujt nuk i bënë përshtypje, disa të tjerë filluan të thonë "mirë paskeni bërë, ky qytet duhet të ketë identitet". Ne, modest, pak me fajin se pse e morëm

këtë përgjegjësi vazhdojmë të jemi pjesë e hartimit të planit zhvillimor komunal dhe urban, të gatshëm të përcjellim ndjenjat e qytetarëve për një qytet me bashkëkohor.

Retushimet mbase nuk janë të dëshirueshme, por rimodelimet gjithse si janë të imponueshme. U bindëm se qyteti jonë ka nevojë për një rimodelim, për një këndvështrim dhe trajtim tjetër, për një vizion tjetër.

Ne do të ishim të kënaqur nëse kemi arritur të krijojmë një parafytyrim më shumë për qytetin tonë, do të ishim të lumtur poqese ai parafytyrim nesër bëhet pjesë e identitetit të Ferizajt të ri.

### Afrim Demiri

*Anëtar i KJSHC (Këshilli Joformal i Shoqërisë Civile)*

## SHOQËRIA CIVILE KA ROL TË RËNDËSISHËM NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR E URBAN NË KOMUNËN E GJILANIT

Programi i MuSPP/UN-HABITAT në Kosovë, Komuna e Gjilanit–Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient (DURA) si dhe Këshilli Joformal i Shoqërisë Civile në Gjilan kanë organizuar punëtorinë për Vizionin e Gjilanit e cila është mbajtur në Oher.

Kjo punëtori me karakter pune, 4 ditore, synim ka pasur Vizionin për të ardhmën e Komunës së Gjilanit. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë dhe profesionistë të Komunës si dhe përfaqësues të programit MuSPP/ UN-HABITAT.

Është punuar në 5 grupe: grupi i infrastrukturës, mjedisit dhe shfrytëzimit të tokës, grupi për demografi dhe çështje sociale, për zhvillim ekonomik si dhe grupi i planerëve të komunës të cilët punuan në të gjitha temat.

Gjatë 4 ditëve është punuar me një përkushtim të madh nga të gjithë; ka mbretëruar klimë e ngrohtë bashkëpunimi në mes të gjithë pjesëmarrësve dhe me këtë mund të konkludohet se komuna është ngushtë e lidhur me të gjithë akterët e planifikimit e posaqërisht me shoqërinë civile. Punëtorja

është vlerësuar e suksesshme dhe MuSPP programi meriton falenderim të madh që ka ndihmuar dhe financuar këtë punëtori.

Në këtë punëtori është prezentuar shkurtimisht kujtesa për të kaluarën e komunës, ku pastaj është paraqitur edhe në hartë. Është punuar në Analizën e Gjendjes (SWOT) e cila më pas u përcjell në vizionin për qytetin; Objektivat dhe prioritetet u prezentuan grafikisht në harta dhe u diskutuan nga të gjitha grupet. Këto prezantime sollën ide të ndryshme, dhe kjo na lë të kuptohet se qytetarët e Gjilanit i preokupojnë problemet e njëjta ndaj dhe propozimet për zgjidhje shpesh herë harmonizoheshin.

Në këtë punëtori Shoqëria Civile ka dhënë kontribut mjaft të rëndësishëm duke u zotuar se nuk do të kursehen edhe në të ardhmën që të ndihmojnë procesin e planifikimit. Vlen të ceket se ky nuk ishte takimi i parë me shoqërisë civile e komunës.

Rezultatet e punës nga punëtorja në Oher janë prezentuar para qytetarëve të komunës dhe strukturave institucio-

nale, më 17 prill 2007 ku kanë marrë pjesë mbi 200 pjesëmarrës të ftuar dhe nga të gjithë është kërkuar të japin idetë e tyre, qoftë në përkrahje të ideve të prezentuara ose të prezentojnë ide të reja, në mënyrë që drafti i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHU) të pasuret edhe më tepër. Kjo do të krijonte ndjenjën se këto dy dokumente janë pronë e të gjithëve dhe se do të vazhdohet kështu bashkarisht në zbatimin e tyre.

Ky prezantim i punës është vazhdimësi e shumë aktiviteteve të mëhershme dhe kjo do të vazhdojë edhe më tej deri në aprovim të PZHK/ PZHU.

### Sevdije Maliqi,

*Drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Mjedis*



## PREZANTIMI I SHKURTËR I VIZIONIT SHOQËRISË CIVILE PËR GJILANIN 2015+

Si përfaqësues i OJQ-së "Qendra Kosovare për bashkëpunim Ndërkombëtar" pata kënaqësinë të jem pjesë e shoqërisë civile gjatë procesit të Vizionimit të Komunës së Gjilanit në periudhën 2007-2015+. Ndonëse kjo ishte diç e re për mua dhe pjesëmarrësit tjerë nga Shoqëria Civile e Komunës së Gjilanit, megjithatë, kjo ishte një mundësi më tepër që edhe ne si qytetarë të rëndomtë, të paraqesim ëndrrën tonë të bukur, për komunën tonë në një periudhë jo shumë të largët, Vizionin e Gjilanit 2015+.

Punëtorja e mbajtur në Ohër nga 30 Marsi deri më 4 Prill 2007 rezultoi pozitivisht. Mbase ambienti i punës gjatë punëtorisë, ndarja e pjesëmarrësve në grupe etj kontribuan në arrijtjen e rezultateve konstruktive.

SWOT analiza e gjendjes faktike, ka nxjerrë në pah edhe përparësitë dhe dobësitë por edhe mundësitë dhe kërcënimet dhe kjo pastaj ka shërbyer për të iu qasur zhvillimit të vizionit se si do të duhej të dukej Gjilani si Komunë në vitin 2015+. Kështu, lidhur më përparësitë në këtë Analizë janë identifikuar komponentët vijues: popullata e re dhe e arsimuar, klima e volitshme ndërnacionale, diaspora e fortë, toka pjellore, Gjilani si komunë ndërkufitare, etj. Sa i përket dobësive, janë potencuar: udhëheqja e dobët, papunësia e madhe, politikat fiskale dhe kreditore të pa favorshme, ndërtimet jo formale, shndërrimi i tokës pjellore në djerrina, etj. Kurse për mundësitë: investimet e huaja, tërheqja e donacioneve përmes projekteve të mira, privatizimi dhe aktivizimi i ndërmarrjeve, shfrytëzimi racional i tokës, ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe infrastrukturës rrugore, etj. dhe në fund, lidhur më kërcënimet janë identifikuar: mos definimi i statusit të Kosovës, shpërthimi i pakënaqësive për shkak të gjendjes së rëndë sociale, mungesa e subvencioneve ekonomike, mungesa e energjisë elektrike, decentralizimi, etj.



Këto elemente të kësaj analize por edhe të tjerat që nuk janë përmendur këtu, më pas na kanë shtyrë të mendojmë se si do të duhej të veprimej në të ardhmen, në mënyrë që ky vizionim të mos mbetet vetëm një ëndërr e bukur por që kjo të bëhet realitet. Kështu, e tërë puna e këtij grupi në fund të punëtorisë është paraqitur me një fjali, me Deklaratën e Vizionit për Gjilanin 2015+:

*Gjilani i integriteteve, urë e kulturave të ndryshme dhe mjedisëve të shëndosha urbane e rurale, me potencialin e vet rinor, natyror dhe diasporën drejt Evropës*

Dhe në fund domosdoshmërisht duhet veçuar edhe rekomandimet e nxjerra për institucionet:

- Institucionet e nivelit lokal dhe qendror që janë përgjegjëse për fushën e planifikimit hapësinor, duhet të jenë shumë më të efektshme në kuptim të funksionimit sipas ligjeve në fuqi dhe sipas nevojës t'i qasen miratimit të ligjeve dhe rregulloreve të tjera të cilat do të ngritnin efektshmërinë në terren. Pra, duhet pasur një koordinim më të mirë të Drejtorisë së Urbanizmit, Rindërtimit dhe Ambientit, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Policisë, etj.
- Nisma për hartim të çfarëdo plani zhvillimor respektivisht plani

regullativ, do të duhej të përcillej me moratorium të gjendjes në terren, të ndërpriten urgjentisht ndërtimet pa leje

- Duhet të ketë angazhim nga të gjithë faktorët relevantë në drejtim të ngritjes së vetëdijes së qytetarit me qëllim që secili të japë kontributin e vet në realizimin e vizionit për një Komunë respektivisht një vend më të mirë – shkollat, OJQ-të, institucionet tjera, ...
- Të nisë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve (të gjitha nivelet) dhe shoqërisë civile si domosdoshmëri dhe mundësi që proceset të ecin tutje në mënyrë më të sigurtë.

Në këtë kontekst, shoqëria civile e Gjilanit shpreh gatishmërinë që të vazhdojë punën në procesin e nisur. Mbase do të kemi përkrahjen edhe të qytetarëve e edhe të institucioneve kurse përkrahjen e UN-HABITAT-it dhënë shoqërisë civile dhe institucioneve dhe puna të cilën janë duke bërë në tërë Kosovën duhet përshëndetur dhe përkrahur pa rezervë.

### Enver Këqiku

Drejtor ekzekutiv i OJQ "Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar"

## PROFILI I KOMUNËS SË PRIZRENIT – ÇKA MË TUTJE?

Më 28 mars 2007, Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me MuSPP/ UN-HABITAT-in organizoi një punëtori më titull "Profili i komunës së Prizrenit – Çka më tutje?" Në punëtori morën pjesë anëtarët e shoqërisë civile, të Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile (KJOSHC), të Ekipit Komunal të Planifikimit (EKP) dhe palët e tjera me interes që veprojnë në komunë.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të vlerësojë draftin e Profilin të Komunës të përgatitur nga EKP dhe MuSPP/ UN-HABITAT me qëllim që të identifikohen çështjet dhe sfidat kryesore përmes analizës SWOT (Përparësitë; Dobësitë; Mundësitë; Rreziqet).

UN-HABITAT e filloi punëtorinë me një prezantim mbi atë se çka është SWOT-i dhe se si duhet bërë analizën SWOT, e cila u pasua nga dy prezantime të EPK-së të cilat paraqitën draftin e profilit dhe kapacitetin për investime. Prezantimet u ofruan pjesëmarrësve njohuri të përgjithshme të cilat pastaj ua mundësuan atyre ta vlerësojnë profilin në mënyrë kritike.

Punëtorja vazhdoi pastaj me diskutime interaktive për kapacitetet për investime dhe për procesin e planifikimit. Pjesëmarrësit gjithashtu shprehën inetresin e tyre për të kontribuar edhe në fazën tjetër të këtij procesi.

Punëtorja dhe paraqitja e komenteve dhe kontributeve të vlefshme rreth draftit të profilit po ashtu i dha mundësi shoqërisë civile dhe planifikuesve/zyrtarëve komunalë që të punojnë së bashku në frymën e një procesi planifikues me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, krahas elementeve të ndërtimit të kapaciteteve.

Në fund duhet thënë se puna e lartpërmendur do ta përmirësojë gjendjen e përgjithshme të planifikimit hapësinor në Prizren duke ofruar bazë të fortë për një Punëtori mbi vizionin, e cila do të jetë hapi tjetër drejt zhvillimit të një Plani të mirë Zhvillimor Komunal (PZHK) për Prizrenin.

## PUNËTORIA E VIZIONIMIT PRIZRENI 2015+

*"Prizreni, këtu fillon..."*

Me moton e lartpërmendur, një grup i qytetarëve dhe planerëve profesionistë nga Prizreni shprehën qartë se Prizrenit i nevojitet një e ardhme e re, duke marrë parasysh trashëgiminë e historike dhe kulturore të tij. Motoja është shoqëruar me deklaratën e elaboruar të vizionit.


Sikurse edhe në punëtoritë tjera të Vizionimit për Mitrovicën, Ferizajn dhe Gjilanin, një grup i vogël i qytetarëve dhe planerëve profesionistë ishte përzgjed

hur për të përpiluar vizionin e përbashkët gjatë një punëtorie e cila u mbajt në Ohër prej 3 deri më 7 qershor. Më tutje pjesëmarrësit e zotuar shkuan përgjatë gjithë ciklit të planifikimit: mësimi i ABC së planifikimit, bërjen së bashku të hartës së kujtimeve, përzgjedhjen e temave dhe çështjeve, analiza SWOT, identifikimi i strategjive dhe objektivave, dhe mbi të gjitha vizualizimi i strukturës hapësinore të dëshiruar për Prizrenin. Por mbi të gjitha, e mira e përdorimit të "forma

tit të standardizuar të vizionimit" i përdorur deri më tani është që rezultatet janë gjithmonë specifike dhe të ndryshme.

Secili qytet dhe lokalitet meriton të ardhmen e tij dhe nuk mund t'i imponohet një vizion i ndonjë komune tjetër. Të gjithë partnerët e punëtorisë së vizionimit, pjesëmarrës dhe organizatorë ishin të kënaqur me rezultatet dhe formën e punëtorisë si dhe punën e bërë së bashku për të pasur një proces me pjesëmarrje dhe më gjithëpërfshirës të planifikimit hapësinor në Prizren.

Më 18 qershor, vizioni i Prizrenit u prezantua publikisht në Sallën e Kuvendit Komunal, në pjesëmarrjen e Kryeshefes Ekzekutive (KSHE), Znj. Mybera Shala-Mustafa dhe mediave lokale e qendore. KSHE e mirëpriti vizionin si një kontribut i rëndësishëm për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe llogarit në zotimin e mëtejshëm të shoqërisë civile dhe UN-HABITAT-it për të vazhduar edhe më tej të punojnë së bashku me autoritetet komunale drejt një PZHK-je vërtet gjithëpërfshirës.



## GJAKOVA ZBATON INDEKSIN E QEVERISJES URBANE

Si hartohet buxheti i komunës? A bën komuna ndonjë hulumtim për atë se sa janë klientët e kënaqur me shërbime? A ka deklaratë të vizionit? A ka ndonjë deklaratë të botuar e cila ua njih qytetarëve të drejtën për qasje në shërbime themelore?

Këto dhe shumë pyetje tjera bëjnë pjesë në Indeksin e Qeverisjes Urbane (IQU), instrument ky që është zhvilluar nga UN-HABITAT-i për analizimin se sa i përmbushin qeveritë lokale në mbarë botën normat dhe parimet e paraqitura në Fushatën Globale për Qeverisje të Mirë.

Një grup prej 25 treguesve ndahen në katër kategori, të cilat pasqyrojnë parimet e efektivitetit, paanësisë, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies.

Pas prezantimit të përgjithshëm të IQU-së, e cila iu prezantua në Prishtinë në një numri të palëve të interesuara dhe partnerëve, ku bënë pjesë institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare, komuna e Gjakovës u paraqit në mënyrë vullnetare që të përdorë këtë instrument për vlerësimin e punës së saj.

Për dy ditë me radhë, një ekip i përbërë nga zyrtarë komunalë, përfaqësues të shërbimeve publike, anëtarë të Kuvendit Komunal dhe përfaqësues të shoqërisë civile diskutuan për treguesit dhe dhanë përgjegjje të hollësishme në këto pyetje.

Pas mbledhjes së të gjitha të dhënave të nevojshme dhe pas plotësimit të tabelave të llogaritjes, komuna do

të nxjerrë rezultatet dhe do të jetë në gjendje të krahasojë punën e vet me punën që bëhet në 24 qytete tjera në mbarë botën, të cilat tashmë kanë marrë pjesë në këtë ushtrim. Gjakova nuk është qyteti i parë i Kosovës që punon me IQU.

Gjatë fazës së zbatimit edhe Prishtina ishte ftuar që të marrë pjesë në testimin e këtij instrumenti në terren. Komuna e Ferizajit poashtu ka treguar interesim të madh për aplikimin e këtij instrumenti në një të ardhme të afërt.

Pas diskutimeve me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Administrimit (MPLA), ekipi i MuSPP-it dhe MPLA do të punojnë së bashku për të zhvilluar treguesit përkatës më specifik për komunat e Kosovës.

## LOKALITETI ZATRA NË KOMUNEN E PEJES SI PIKE TESTUESE E PLANIT RREGULLUES URBAN

Lokaliteti Zatra sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe atij Urban (PZHU) është identifikuar si një nga vendbanimet joformale (VJF) dhe projektet prioritare në komunën e Pejës.

Në partneritet me komunën e Pejës si dhe programin MuSPP të UN-HABITAT-it zyra në Pejë, dhe mbështetur nga ATRC, IREX dhe USAID, OJQ "Syri i Vizionit" ka hartuar projektin "Planifikimi Urban për lagjen "Zatra".

Objektivat kryesorë të projektit janë:

- Mobilizimi i komunitetit për fazën fill-estare të procesit konsultativ për hartimin e Planit Rregullues Urban (PRrU) për vendbanimin Zatra dhe
- Udhëheqja e analizës socio-ekonomike dhe urbane për vendbanimin Zatra


Në plan të parë janë zhvilluar konsultimet e para në këtë zonë, takimet me banorët e lagjes Zatra, me ç'rast ata janë njoftuar mbi PZHK/ PZHU. Gjatë këtyre takimeve informuese banorët e Zatra-s diskutuan për nevojat dhe

problematikat që kanë qytetarët dhe për mundësinë që këto problematika dhe sugjerime t'i bashkëngjiten Planit Rregullues Urban, për realizimin e tyre në aspekt më afatgjatë kohor.

Vlerësimi i gjendjes përmes metodës së SWOT analizës, është bërë në kuadër të një punëtorie tjetër, ku fushat tematike të përzgjedhura ishin: banimi, mjedisi, infrastruktura, punësimi, zhvillimi ekonomik, sporti, turizmi etj. Rezultatet e dala nga kjo analizë do të mund të futeshin në shërbim të hartimit të PRrU.

Pjesë e këtij projekti ka qenë edhe hulumtimi në këtë zonë, me qëllim të njohjes më të mirë të gjendjes ekzistuese në aspektin urban, mjedisor, social dhe ekonomik.

Për këtë qëllim janë përgatitur pyetësor specifik të cilët kanë shërbyer për mbledhjen e të dhënave në secilën prej 350 shtëpive sa përmban ky lokalitet. Të dhënat e dala nga pyetësorët do të organizohen dhe do të futen në bazën



e të dhënave komunale.

OJQ "Syri i Vizionit" do të përcjellë fazën tjetër të punës dhe mundësinë që edhe në vendbanimet tjera jo formale të jetë e involvuar në aspektin e ndihmës së komunitetit për pjesëmarrje direkte në vendimet që merren për lokalitetin e tyre dhe mjedisin ku ata jetojnë.

### Fatmir Ramaj

Koordinator i projektit në OJQ "Syri i Vizionit"-Pejë

## EVALUIM POZITIV PËRSA I PËRKET HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK) DHE PLANIT ZHVILLIMOR URBAN (PZHU)

Kryetari i Mitrovicës, Mursel Ibrahim, Kryeshefi Ekzekutiv, Sadri Ferati si dhe drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Ndërtim dhe Banim, Fejzullah Haxhani, gjatë takimit me Jusuf Haxhimehmeti, drejtorin e Kompanisë Konsulente "Lin Projekt", e cila është duke hartuar PZHK/PZHU, diskutuan zhvillimet e deritanishme në procesin e planifikimit, si dhe mënyrën se si t'i evitojnë pengesat, mangësitë si dhe vështirësitë

eventuale të cilat mund të paraqiten gjatë procesit.

Pjesëmarrësit vlerësuan pozitivisht punën e bërë deri më tani, dhe u pajtuan me atë se përderisa draft dokumenti i fazës së parë do të përmirësohet sipas sygjërimeve të planerëve komunalë, do të vazhdohet me punë në fazën e dytë, e nënkupton definimin e vizionit për të ardhmen e qytetit, parimet dhe qëllimet

për zhvillim të qëndrueshëm.

Definimi i vizionit, u tha në takim, është element qenësor për fazën e tretë e cila konsiston në përgatitjen e koncepteve të ardhshme të zhvillimit.

*Burimi: Buletini komunal NO.1/2007, 30 Prill*

### MËSIMET NGA EKSPERIENCA ZVICERANE

Aktualisht komuna e Mitrovicës është në proces të hartimit të PZHK/ PZHU. Si konsulentë përkrahës të komunës në procesin e hartimit të planeve janë emëruar kompania vendore LINPROJEKT në bashkëpunim me kompaninë zvicerane METRON Raumentwicklung nga Brugg-u. Si pjesë e procesit të planifikimit, prej 16-18 Prill 2007, tre planerë komunalë dhe dy planerë nga kompania konsulente LINPROJEKT ishin në vizitë pune te METRON në Zvicër.

Qëllimi kryesor ishte prezantimi dhe finalizimi i raportit të draft dokumentit mbi Analizën e gjendjes së zhvillimit urban dhe komunal.

Pjesë e takimit punues ishte edhe një vizitë studimore terreni në komunën e Schlieren-it, të cilët prezentuan përvojat e tyre prej hartimit e deri te zbatimi i një projekti zhvillimor për një zonë të qytetit autor i të cilit ishte kompania Metron. Ky prezantim u ndoq me kërshëri pasi që Schliereni me të kaluarën e tij industriale asoconte analogji me Mitrovicën.

Zgjidhjet e propozuara si: Koncepti i përzjerjes së banimit dhe punësim-it, funksionalizimi i komunikacionit ekzistues, shënimi i shtigjeve për



këmbësorë dhe biçiklistë, koncepti i krijimit të kushteve për hapësira të lira për gjelbërim, pushim dhe rekreacion si dhe koncepti se ku mund të ndërtohet me etazhitet të lartë e ku jo, janë parë si shumë të afërta me qasjen e planerëve komunalë në trajtimin e këtyre çështjeve.

Zonimi i planifikimit ishte dëshmuar si mjet i fuqishëm me të cilin investitorëve iu imponohej bashkëpunimi me komunën, për të parandaluar ndërtime ilegale, dukuri kjo që për befasinë e planerëve të Mitrovicës ishte prezente edhe në Zvicër.

Punëtorja në Zvicër dëshmoi edhe njëherë se pa kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet të gjithë akterëve kyç në procesin e planifikimit strategjik, nuk mund të ketë planifikim të qëndrueshëm.

Autorët:

**Fejzullah Haxhani,**

*Drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim dhe Banim*

**Xhemshir Mulliqi,**

*Shef i sektorit të planifikimit*

**Bedri Asllani,**

*Planer komunal*



## ZVOGËLIMI I VARFËRISË DHE MEKANIZMAT E QENDRUESHËM FINANCIAR SI FOKUS I KËSHILLIT TË 21-TË DREJTUES

Çdo dy vjet, puna dhe marrëdhëniet e UN-HABITAT-it me partnerët e tij shqyrtohen deri në hollësi nga një Këshill drejtues i përbërë nga 58 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Ky është një forum i një niveli të lartë të përfaqësimit të qeverive në nivel ministror, i cili përcakton politikat e UN-HABITAT-it dhe miraton programin e punës së agjencisë dhe buxhetin për dy vitet e ardhshme.

Seanca e 21-të e Këshillit Drejtues (KD21) e Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet e Njerëzve, (UN-HABITAT) u mbajt prej datës 16 deri më 20 Prill 2007 në selinë qendrore të UN-HABITAT-it në Nairobi të Kenisë dhe u përqendrua në temën kryesore Urbanizimi i qëndrueshëm: veprimi lokal për zvogëlimin e varfërisë në zonat urbane me theks të veçantë në financa dhe planifikim.

Përveç takimeve të nivelit të lartë ministror, në këtë seancë të Këshillit Drejtues u zhvilluan edhe një varg ngjarjesh interesante paralele ku morën pjesë ekspertë, organizata të shoqërisë civile dhe zyrtarë të qeverive lokale.

Duke u fokusuar në zvogëlimin e varfërisë dhe në financimin e qëndrueshëm, këto



ngjarje paralele ofruan një pasqyrë të hollësishme të progresit drejt arritjes së Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit në botën që po urbanizohet në mënyrë të shpejtë, me politika menaxhuese të tokës në favor të njerëzve të varfër dhe gjinisë femërore dhe me mekanizma të qëndrueshëm financiar për të ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetës për të varfrit përmes mekanizmave mbështetës publiko-privat.

Këshilli Drejtues miratoi rezolutat përkatëse të cilat e nxisin UN-HABITAT-in dhe qeveritë shtetërore për t'i adresuar këto çështje.

Seanca e Këshillit Drejtues u mundëson këshilltarëve kryesorë teknikë dhe zyrtarëve të lartë të programeve shtetërore që veprojnë në kuadër të Programit për Menaxhimin e Fatkeqësive (PMF), që të takohen, të shkëmbejnë përvojat dhe të diskutojnë çështjet me interes të përbashkët, siç është shkëmbimi i punonjësve brenda programeve ekzistuese për të përfituar nga ekspertiza e fituar në vendet tjera.

Ata u pajtuan që të punojnë në dokumente tematike të bazuara në përvojat në terren dhe në mësimet e mësuara. PMF-ja është duke zhvilluar programet e saj në Somali, Sudanin Jugor, Pakistan, Kosovë, Indonezi, Afganistan dhe Shri Lankë dhe ka zyrat e veta kontaktuese edhe në Liban dhe Ugandë.

Këshilli Drejtues po ashtu miratojë buxhetin dhe planin strategjik afatmesëm të UN-HABITAT-it.

*Më shumë rreth Këshillit drejtues mund të lexoni në faqen e internetit të UN-HABITAT-it: [www.un-habitat.org](http://www.un-habitat.org)*

## UN-HABITAT-I MBËSHTET ME ENTUZIAZËM PLANIFIKIMIN URBAN

Gjatë këtij muaji UN-HABITAT-i ka konfirmuar sërish qëndrimin e tij se planifikimi urban është duke u bërë gjithnjë e më i rëndësishëm në menaxhimin e ndryshimeve klimatike sepse qytetet e planifikuara mirë ofrojnë bazë më të mirë për zhvillim të qëndrueshëm se sa qytetet pa plan.

Gjatë paraqitjes në emër të saj në Negociatat për klimën të mbajtura në Bon të Gjermanisë, Drejtoresha Ekzekutive e UN-HABITAT-it, Znj. Anna Tibaijuka tha se duke filluar nga viti 2007, rreth pesëdhjetë përqind e popullsisë në botë jetojnë në zonat urbane.

"Planifikimi urban ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në klimë pasi që zonat urbane janë prodhuesit më të mëdhenj të emetimeve të gazit të serrave prandaj ato kanë ndikim mjaft të madh edhe në ndryshimet klimatike.

UN-HABITAT-i i trajton ndryshimet klimatike dhe zhvillimin urban, elementi kyç i të cilit është planifikimi urban, si pjesë të mandatit të saj. Kjo është e paraqitur edhe në Agjendën e Habitatit në bazë të planit global të veprimit: Strategjitë për zbatim," tha ajo.

Znj. Tibaijuka sqaroi se agjenda e mi-

ratuar nga të gjitha shtetet anëtare të KB-së, e thekson përkushtimin e Habitatit për një shfrytëzim të qëndrueshëm të energjisë dhe për transport të qëndrueshëm, dy çështjet këto kyçe për zbutjen e ndryshimeve klimatike si dhe elementi i planifikimit urban.

Si rezultat i mandatit të tij, UN-HABITAT-i duhet të punojë bashkë me partnerët në agjendën e Habitatit për të përdorur planifikimin dhe zhvillimin urban si masë për zbutjen e ndryshimit të klimës.

*Burimi: [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)*

## TAKIMI SHQYRTUES TRE-PALËSH (TPR) MBI PROGRAMIN MUSPP

Përfaqësues të Programit MuSPP të UN-HABITAT-it në Kosovë, të Qeverisë Suedeze/ Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe gjashtë komunat përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile u takuan në Prishtinë më 10 maj 2007 për të rishqyrtuar aktivitetet e tanishme të programit MuSPP, diskutuar sfidat dhe zhvillimin e ardhshëm të programit. Znj. Elisabeth Belpaire, Krye-Këshilltare Teknike e UN-HABITAT-it në Kosovë, raportoi mbi të arriturat dhe sfidat e programit. Homologët nga MMPH, Z. Merxhan Avdyli, zëvendës-Ministër, Znjsh. Ms. Karen McDonalds, Drejtoreshë e Sida-s në Kosovë, dhe Sazan Ibrahim, drejtor i Asociacionit të Komunave të Kosovës falënderuan UN-HABITAT-in për punën që po e bën në kuadër të MuSPP programit (financuar nga Sida), i cili synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe i kontribuon zhvillimit ekonomik. Praktikën e mira duhet të ndahen me të tjerët dhe ky takim është rast i mirë për këtë.

Të arriturat në procesin e planifikimit në komunat në kuadër të MuSPP programit janë shumta dhe variojnë nga njëra komunë në tjetrën.

- Prezantimi i **Ferizajt** tregoi për gatishmërinë politike dhe të shoqërisë civile për të mbështetur procesin e planifikimit. Shoqëria civile i dorëzoi Kryetarit "Deklaratën e Vizionit" e cila ngërthen zërin e qytetarëve; "Mobilitet për të gjithë" i përkthyer në "Projektin e Qendrës Mobile" në partneritet publiko-privat; unaza e rrugore e propozuar dhe identifikimi i vendbanimeve joformale me përfshirjen e OJQ-ve Rinore në bërjen e studimit, janë vetëm disa shembuj që tregojnë për progresin në procesin e planifikimit.
- Komuna e **Gjilanit** është zotuar për një proces gjithëpërfshirës në planifikim. Të arriturat përfshijnë bashkëpunimin e madh ndërsektorial me një mori raportesh sektorale dhe strategji; Vizionimi me të rinjtë në ditën e Habitat-it ishte pika nismëtare për të nxjerrë vizionin e qytetit i cili më pas vazhdoi me angazhimin e shoqërisë civile në Takimin Punues të Vizionimit, prezantimin publik si dhe intergrimin e rezultateve në PZHK/PZHU.
- Trajtimi i vendbanimeve joformale si pjesë e procesit të planifikimit për të

siguruar një jetë më të mirë për banorët e tij, është një ndër prioritetet e komunës së **Gjakovës**. Të arriturat e MuSPP programit në këtë komunë përfshijnë edhe Planin për Përmirësimin e Lëvizshmërisë (mobilitetit) si dhe themelimin e Këshillit Joformal të Shoqërisë Civile (KJSHC). Themelimi i Njesisë së Planifikimit mbetet ende sfidë e programit.

- Përkundër situatës politike në **Mitrovicë** e cila sfidon procesin e planifikimit, MuSPP programi ka arritur të sjellë së bashku përfaqësues të shoqërisë civile nga të dy anët e qytetit që së bashku të punojnë në përmirësimin e mjedist jetësor të tyre



përmes takimit punues të vizionimit që u mbajt në janar. Puna e mëtejme vazhdon në përmirësimin e mobilitetit dhe transportit për të dy anët e qytetit.

- Komuna e **Pejë**s është rast interesant meqë paraqet komunën e parë në Kosovë me Planin Zhvillimor Komunal të miratuar nga MMPH. Përfundimi i planit nuk është fundi i procesit të planifikimit; procesi i vërtetë fillon me zbatimin e planit dhe planerët komunalë duhet të jenë forcë shtytëse për finalizimin e PZHK/PZHU dhe të sigurojnë se mësimet e nxjerra nga ky rast do të ndahen me komunat tjera.
- Punimi i planit nga vet komuna me përfshirjen e shoqërisë civile, minoriteteve dhe me një bashkëpunim intersektorial dhe në të gjitha nivelet konsiderohet ende sfidë për komunën e **Prizrenit**.
- **Vendbanimet Joformale (VJF)** ende vazhdojnë të jenë prioritet i lartë për MMPH, por që asgjë nuk mund të zbatohet përderisa shoqëria civile nuk është e involvuar dhe informuar. Një kampanjë mbarë-kosovare mbi Përmirësimin dhe Rregullarizimin e VJF, takimet punuese mbi shkëmbimin e përvojave

dhe mësimet e nxjerra nga shembuj të ndryshëm në komuna janë konsideruar të arritura të MuSPP programit.

- **Pjesëmarrja e shoqërisë civile** si partner në procesin e planifikimit (në disa raste përmes KJSHC të formuar) është evidente në çdo aktivitet të MuSPP-it.
- Ofrimi i ekspertizës në çështjet e **mobilitetit** që afektojnë procesin e planifikimit si dhe **mbështetja ligjore** për komunat i shtojnë vlerën programit dhe ndihmojnë komunat partnere t'ia dalin mbanë me sfidat në planifikim.
- Një **mori veglash të zhvilluara për të mbështetur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave** në aktiv

itetet e planifikimit me dhe në mes komunave si dhe audiencës në përgjithësi, konsiderohen të arritura të programit.

Konkluzionet dhe fushat për tu fokusuar në muajt e ardhshëm:

- Avancimi i ciklit të tanishëm të planifikimit, finalizimi dhe dorezimi i draft Planeve Zhvillimore Komunale për tu aprovuar deri në fund të tetorit 2007. Një plan i aprovuar është bazë e rëndësishme për fazën e ardhshme të planifikimit si dhe për investime kapitale
- Dialog i strukturuar në mes të MMPH dhe komunave përmes mekanizmave kontruktivë të reagimit dhe fokusimi në fushat më të rëndësishme
- Replikimi dhe shkëmbimi i praktikave të mira në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe komunave
- Të shkohet drejt veprimeve dhe rezultateve konkrete, të cilat lidhen me PZHU/PZHK; e jo në veprime ad-hoc
- Komunikimi i vazhdueshëm me qytetarët për planifikimin dhe mbështetjen politike



## DELEGACIONI SUEDEZ VIZITON PRIZRENIN

Si pjesë e takimit-Tre Palësh Rishqyr-  
tues, përfaqësues të Qeverisë Sue-  
deze dhe Sida-s (Agjencioni Sue-  
dez për Zhvillim dhe Bashkëpunim  
Ndërkombëtar) në Kosovë, dhe  
përfaqësues të programit MuSPP të  
UN-HABITAT-it vizituan komunën e  
Prizrenit. Delegacioni u mirëprit nga  
Z. Ekrem Kryeziu, Kryetar i komunës  
së Prizrenit, Znj. Mybera Mustafa,  
Kryeshefe e Ekzekutivit si dhe nga

zyrtarë tjerë komunalë. Ky takim  
ofroi mundësi të shkëmbimit të ideve  
në çështjet e planifikimit duke ofruar  
propozime konkrete për bashkëpunim  
e mëtejme mes komunës dhe  
programit MuSPP në të ardhmen.

"Prizreni si qendër tregtare dhe turis-  
tike; komuna më e mirë në vreshtari;  
qytet univerzitar që e ndihmon Uni-  
verzitetin e Prishtinës", është vizioni

për zhvillimin e ardhshëm të këtij  
qyteti, i artikuluar nga Kryetari i Pri-  
zrenit.

Vizita nëpër qytet, prezantimi i gjen-  
djes së tanishme në procesin e pl-  
anifikimit nga planerët komunalë dhe  
diskutimet intreaktive bënë të qartë  
se udhëheqësia e Prizrenit si dhe pro-  
fesionistët janë të zotuar që procesi i  
planifikimit të lëviz si duhet.



Stafi i MuSPP-it

## TAKIMI PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMIT TË UN-HABITAT-IT/MUSPP

Takimi për Zhvillimin e Programit (TZHP) i UN-HABITAT-it/ Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë u mbajt më 9 Mars 2007, në të cilin morën pjesë gjashtë komunat pjesëmarrëse në program dhe partnerë të tjerë të këtij programi. Në fokus të takimit ishte forcimi i planifikimit me pjesëmarrje përmes Këshillit Joformal të organizatave të Shoqërisë civile dhe ristrukturimi i departamenteve të planifikimit për t'iu përshtatur planifikimit hapësinor.

Qëllimi i themelimit të Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile (KJOSHC) ishte që të bashkojë edhe më shumë shoqërinë civile dhe qeveritë komunale në përpjekjet e tyre për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunat dhe qytetet e tyre përmes pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të tyre në procesin e planifikimit. Ndonëse ka shumë OJQ dhe qytetarë aktivë, përpjekjet e tyre nuk janë gjithmonë të bashkërenduara dhe nuk plotësojnë punën e bërë nga administrata komunale. Prandaj, krijimi i një platforme të përbashkët përmes të cilës njohuritë, aftësitë dhe burimet teknike të shoqërisë civile mund të shfrytëzohen më mirë, duket të jetë një zgjidhje shumë praktike.

Duke punuar me planerët komunalë dhe me zyrtarët për çështje gjinore, informim, komunitete dhe kthim, ekipet e MuSPP-së mundësuan themelimin e këtyre këshillave në Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan dhe Prizren. Anëtarët e këshillave joformalë kanë luajtur rol aktiv në përgatitjen e punëtorëve për vizionim dhe kanë shërbyer si instrumente në zhvillimin e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë lokale për periudha afatgjata.


Roli i KJOSHC-së nuk është që të zëvendësojë Këshillin e ekspertëve të planifikimit, detyra parësore e të cilëve është që të ofrojnë ekspertizën e tyre dhe të japin këshilla teknike rreth procesit të planifikimit, por që të përfaqësojë interesat më të gjera të

qytetarëve dhe që të ndihmojë që zëri i tyre të dëgjohet. Detyrat e Këshillit Joformal të organizatave të shoqërisë civile janë të përqendruara në promovimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në debate publike, në ndihmën për qeveritë lokale, në mobilizimin e angazhimit aktiv të qytetarëve në konsultimet për çështje urbane, inicimin e takimeve të tilla në bashkëpunim me qeveritë lokale dhe në fund, por jo edhe e fundit për nga rëndësia, të ndihmojë në krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm të bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverive lokale.

Diskutimi rreth njësive komunale të planifikimit, që ishte tema e dytë, filloji me studimin e gjendjes ekzistuese në gjashtë komunat pjesëmarrëse në raport me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit për planifikim hapësinor, si dhe me kapacitetet e departamenteve/drejtorive të urbanizmit në kryerjen e aktiviteteve planifikuese (kjo pastaj theksoi nevojën që drejtoritë e planifikimit të ristrukturohen për t'ua mundur atyre që tu përgjigjen më mirë sfidave të tanishme dhe të ardhshme në kontekst të botës që është duke u urbanizuar dhe globalizuar).

Sa i përket njësisë për planifikim, dokumenti i prezantuar për diskutim shkoi me tej duke propozuar katër variante alternative për komunat e mëdha dhe të vogla, me qëllim që planifikimi hapësinor në Kosovë të jetë më afër standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare. Variantet ndryshonin sa i përket numrit të punonjësve komunalë të angazhuar në procesin e planifikimit; shkallës së angazhimit të tyre dhe vendosjes së njësisë brenda strukturës komunale.

UN-HABITAT/ MuSPP theksoi se dokumenti ishte dokument për t'iu diskutuar dhe që mund të ndryshojë dhe bëri thirrje për një diskutim të lirshëm dhe të hapur rreth dokumentit. Kjo qoi në një diskutim të mirë interaktiv në mes të pjesëmarrësve dhe u ngritën një varg shqetësimesh rreth varianteve të propozuara. Me rëndësi ishte se pati



një njohje të nevojës për të ndryshuar gjendjen e tanishme të strukturës së departamenteve të planifikimit dhe shumica prej tyre mirëpritën variantet e propozuara, por të cilat kishin nevojë të përshtateshin. Me paraqitjen e këtyre shqetësimeve dhe komenteve UN-HABITAT/ MuSPP synon që të përmirësojnë dokumentin për përfshirjen e komenteve të bëra nga pjesëmarrësit dhe të vazhdojnë konsultimet e mëtejshme palët përkatëse.

## KËNDI I MEDIAVE

**Në këndin e Mediave kemi zgjedhur disa tituj e citime interesante në lidhje me planifikimin urban dhe zhvillimet në Kosovë. Artikujt origjinalë mund t'iu dërgohen sipas kërkesës.**

**MITROVICË****Qytetarët në planifikim-çelës për qeverisje të mirë**

Artikulli ofron vështrime nga tryeza e rrumbullakët e titulluar "Zbatimi i demokracisë në qeverisje të mirë nga perspektiva e planifikimit". E ndjekur nga shoqëria civile nga veriu dhe jugu i Mitrovicës, tryeza nxori në përfundim se përfaqësimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile në çështjet e planifikimit është çelës për qeverisje të mirë.

Qytetarët dhe shoqëria civile janë akterë në vizionimin e qytetit, dhe se vizioni i qytetit është i rëndësishëm për të pasur një jetë më të mirë në komunë. Vizionimi për Mitrovicën është pjesë e programit "Së Bashku Bëjmë Qytete më të Mira", që është slogani i Programit të UN-HABITAT-it për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë, i financuar nga Sida.

*Burimi: Koha Ditore, 26/03/2007*

**FERIZAJ****Ferizaj synon të promovojë investimin e qytetarëve**

Udhëheqësit politikë të Ferizajt e konsiderojnë Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban si një projekt kapital të komunës. Së shpejti ai do të jetë vihet në shqyrtim publik.

Artikulli thekson se vonesa e mbajtjes së diskutimit publik arsyetohet me nevojën që projekti të elaborohet më shumë ashtu që produkti final të jetë sa më i mirë. Kryetari i komunës i dha komplimente shoqërisë civile dhe UN-HABITAT-it për pjesëmarrje aktive në procesin e planifikimit.

Sipas këtyre planeve, Ferizaj do të bëhet një qytet atraktiv dhe me zhvillime të hovshme në të gjitha sferat e jetës.

*Burimi: Kosova Sot, 27.04.2007*

**GJILAN****Qytetarët, bashkëhartues të Planit Zhvillimor**

"Nuk do të miratohet plani zhvillimor komunal dhe urban pa i dhënë mundësi qytetarëve t'i shprehin mendimet e tyre", ka thënë Sevdije Maliqi-Hyseni, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Mjedis në Gjilan.

Artikulli gjithashtu ofron edhe të dhëna mbi procesin e planifikimit, si dhe bashkëpunimin me akterë të ndryshëm. Mirënjohje i është dhënë Qeverisë Suedeze e cila mbështet programin e UN-HABITAT-it, i cili ofron ndihmë të përditshme në procesin e planifikimit në Gjilan si dhe në disa komuna të Kosovës.

*Burimi: Kosova Sot, 26/03/2007*

**PEJA****U miratua Plani Zhvillimor dhe Urban i Pejës**

Artikulli përmban informata mbi miratimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban të Pejës për periudhën 2006-2025.

Plani është përgatitur nga një firmë holandeze dhe është Plani Zhvillimor Komunal i pari në Kosovë i miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

*Burimi: RTK, 14/05/07*

**PRIZREN****Qeveria komunale vazhdon të investojë në projektet mjedisore**

Ky artikull ofron të dhëna mbi zonat prioritate të zhvillimit në agjendën e komunës së Prizrenit në këtë vit, duke përfshirë këtu krijimin e oazave të gjelbëra. Në lidhje me këtë, janë pranuar dy projekt-propozime: "Krijimi i hapësirave sipas planit urbanistik të qytetit" dhe vazhdimin e "Ndërtimit të kejit të Lum

bardhit". Zbatimi i këtyre dy projekteve do t'i kontribuojë krijimit të hapësirave të gjelbëra në qytet.

*Burimi: Koha Ditore, 12/03/2007*

**GJAKOVA****Qyteti digjital - si vizion deri në fund të vitit**

Bazuar në strategjinë për zhvillimin e qëndrueshëm, të miratuar nga Kuvendi Komunal më 2005, deri në fund të këtij viti Gjakova është paraparë të bëhet "qytet digjital". Të gjitha institucionet do të pajisen me një infrastrukturë telekomunikuese të bazuar në fijet optike, i cili pritet të ofrojë infrastrukturën e nevojshme për integrimin e shërbimeve të ndryshme në dobi të qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve të komunës. Artikulli thotë që kompletimi i këtij projekti do ta bëjë Gjakovën prijëse në këtë fushë.

*Burimi: Koha Ditore, 05/03/2007*

**Lubljana 2025: Kryeqyteti si një projekt për investime**

Artikulli jep të dhëna interesante në lidhje me vizionin e Lubjanës. Zhvillimi i vizionit të Lubljanës duhet të inkurajojë formimin e imixhit të vet qytetit, duke përcaktuar atë se çka qyteti nënkupton për qytetarët e vet, dhe cilat janë të priturat e tyre në lidhje me zhvillimin e qytetit.

Vizioni është gjithashtu faktor dominues për zhvillimin socio-ekonomik. Vizioni ndihmon të zbulojë përparësitë e qytetit dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim, dhe është posaçërisht element vendimtar në fillimin e hartimit të planeve strategjike.

Meqë vizioni orvatet të krijojë vetëdije kolektive në mes të banorëve të qytetit, atëherë edhe publiku i gjerë duhet të ketë fjalën e tij në të.

*Burimi: Slovenia Times, 11.05.07*

## KONFERENCA MBI GJENDJEN E TANISHME TË PLANEVE ZHVILLIMORE KOMUNALE DHE URBANE NË KOSOVË- SHEMBULLI I PEJËS

Më 19 Prill, Komuna e Pejës, Programi MuSPP i UN-HABITAT-it, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) organizuan Konferencën mbarë kosovare mbi gjendje e tanishme në planifikimin zhvillimor komunal.

Konferenca u mbajt me rastin e përmbylljes së procedurave të aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) si dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHU) të Pejës.

Z.Ukë Kelmendi, drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban e Rural, Zhvillim dhe Mjedis, në komunën e Pejës, konsideron se miratimi i këtyre planeve është e arritur e lartë e kësaj drejtorie.

Z. Frank D'hondt, koordinatori i planifikimit hapësinor të programit MuSPP të UN-HABITAT-it, theksoi se aktivitetet e planifikimit nuk mbarojnë me miratimin e planeve, por që ky shënon një start më të avancuar të kulturës së komunës në planifikim.

Rreth 120 pjesëmarrës, kryesisht planerë dhe vendimarrës nga komunat e Kosovës, si dhe përfaqësues



nga organizatat e shoqërisë civile morën pjesë në këtë ngjarje.

Kontribut në këtë Konferencë dhanë punëtorët e drejtorisë së Urbanizimit të Pejës, përfaqësues të komunave Suharekë, Ferizaj dhe Kamenicë, si dhe përfaqësuesit e OJQ "Syri i Vizionit" të cilët janë të përfshirë në zbatimin e PZHK/ PZHU së për vendbanimin Joformal Zatra. Pjesëmarrja e madhe tregon rëndësinë e planeve të Pejës si shembull

mësimi për komunat tjera. Konferenca përfundoi me një vizitë studimore në Vendbanimin Joformal Zatra si dhe të zonës industriale e paraparë për t'u zgjeruar në të ardhmen

Hapi i fundit në procedurën e miratimit të planeve është arritur më 14 Maj, me aprovimin e të dy planeve atij Zhvillimor Komunal dhe Urban nga Kuvendi Komunal i Pejës.

## DELEGACIONI KOSOVAR NË PUNËTORINË NDËRKOMBËTARE PËR TRANSPORTIN PUBLIK NË SHKUP

"As që mund të fillojë urbanizimi i qëndrueshëm pa e marrë parasysh rolin që e luan transporti publik në sigurimin e një jetë më cilësore në qytetet dhe fshatrat tona", tha Znj. Tibaijuka, Drejtoreshë ekzekutive e UN-HABITAT-it, me rastin e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit me Asociacionin Ndërkombëtar të Transportit Publik (ANTP) në Helsinki më 24 maj. Ajo theksoi se ANTP-ja ishte "partner strategjik që sjell një përvojë të pasur dhe që bart njohuritë e saj në mbarë botën".

Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Publik (ANTP) është organizatë ndërkombëtare për autoritetet dhe operatorët e transportit publik, vendimmarrësit e politikave, institutet shkencore dhe për industrinë e furnizimit dhe shërbimit të

transportit publik. Ajo është platformë për bashkëpunim në mbarë botën dhe për shkëmbimin e njohurive në mes të 2,900 anëtarëve të saj nga 90 vende të botës, përfshirë edhe Kosovën. Në bashkëpunim me ndërmarrja e transportit publik në Shkup (JSP), ANTP-ja zhvilloi një punëtorë për rajonin e Ballkanit me 7 dhe 8 qershor. Delegacioni i Kosovës i organizuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, përbëhej nga përfaqësuesit e qyteteve me madhësi mesatare të Kosovës, të mbështetura nga programi MuSPP.

Kosova mund të jetë krenare për sistemin shumë funksional dhe me kapacitet të lartë të transportit të autobusëve ndërrurban. Sfidat e sotme është themelimi i një sistemi koherent që lidh shërbi-

met e transportit urban me atë komunal, për të siguruar dhe zhvilluar edhe më tej pjesën e transportit publik në kuadër të transportit të përgjithshëm të motorizuar të Kosovës.

"Vullneti politik është element i domosdoshëm për të arritur lëvizje të qëndrueshme në qytetet dhe rajonet tona" deklaroi Hans Rat, Sekretar i përgjithshëm i ANTP-së.

Për ta shndërruar këtë kuptim në veprim, ANTP-ja dhe UN-HABITAT-i do të bashkohen për të mbështetur të gjithë akterët lokalë në ndërtimin e kapaciteteve të mëtejshme për arritjen e këtij qëllimi dhe për krijimin e një sistemi të integruar të transportit publik gjatë muajve dhe viteve të ardhshme.

## FUSHË PUNËTORI MBI VENDBANIMET JOFORMALE NË GJAKOVË

Trajtimi i vendbanimeve joformale (VJF) përmes procesit të planifikimit është një nga prioritetet e komunës së Gjakovës. Në Gjakovë bazuar në karakteristikat e vendbanimeve joformale sipas udhëzuesit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), janë identifikuar këto tri lagje si VJF: "BREKOC", "KOLONIA" dhe "PISKOTA".

Me qëllim që të shihet, ndihet dhe të preket e vërteta e VJF, komuna e Gjakovës së bashku me MMPH, Asociacionin e Komunave të Kosovës, OSBE dhe UN-HABITAT/ MuSPP organizoi një fushë punëtori më 26 Prill, 2007. Kjo punëtori kishte për qëllim që të kontribuojë në përpilimin e politikave lokale dhe qendrore në planin e veprimit mbi Vendbanimet Joformale, të diskutohet se si Plani Urban mund të shmang vendbanimet e reja joformale dhe përmisojë ato ekzistuese dhe të kontribuojë në krijimin e rrjetit të studimit të VJF, gjithashtu dhe krijimin e të qenët i informuar.

Në kuadër të punëtorisë fushore mbi vendbanimet joformale u bënë edhe vizita nëpër lagjet e përmendura, me ç'rast pjesëmarrësit patën rast të shohin më afër të vërtetën për VJF, të arriturat e komunës në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve që jetojnë në këto lagje sidomos Brekoci, si dhe atë se çka ende duhet bërë në trajtimin e këtyre VJF-ve.

Gjate diskutimit të bërë në kuadër të fushëpunëtorisë rekomandimet e dala janë:

### **Brekoc:**

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit është shumë e ngarkuar për të marrë përsipër procesin e identifikimit të VJF dhe për këtë një agjension i dedikuar për këtë është i nevojshëm.
- Komunës i duhen njerëz në identifikimin e VJF. Nevojitet një plan veprimi me qartësim të përgjegjësive i cili është më praktik se sa një strategji.
- Brekoci ka Plan Rregullues me analizën e situatës urbane, por çështjet pronësore mbeten ende të pazgjidhura
- Nevojiten informata të besueshme kadastrale si dhe informata tjera



- Financimi duhet të shihet. Duhet të gjenden donatorë, përfshirë këtu edhe Paktin e Stabilitetit i cili punon në Programin Regjional për Ngritjen e Kapaciteteve. Përveq kësaj duhet që edhe komuna të alokojë buxhet.

- Nevojiten trajnime për komunitetin dhe ai duhet të konsultohet për çdo vendim që mirret për zonën e tyre.

### **Kolonia:**

- Angazhim i nivelit qendror (Ministrisë) si dhe Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit në zgjedhjen e çështjeve pronësore dhe ofrimin e sigurisë banorëve në atë lokacion

- Banorët në këto vendbanime duhet të punojnë së bashku në përmirësimin e kushteve të jetesës, ndoshta duke shfrytëzuar transportin e përbashkët publik, dhe ngritjen e qasjes në shërbimet shëndetësore. Banimi social mund të ofrojë zgjidhje. Është e nevojshme të ketë debate publike për vizionin për zhvillimin e kësaj zone gjatë procesit të hartimit të planit zhvillimor komunal dhe atij urban.

### **Piskota:**

- Nevojiten intervenime afatshkurta dhe afatgjata.

Intervenimet afatshkurta: Ndërtimi i rrugës, instalimi i rrjetit energjetik, ofrimi i shërbimit të kanalizimit dhe mbledhjes së mbeturinave, ndërtimi i digave mbrojtëse

Intervenimet afatgjata: rregullimi i statusit ligjor të tokës, 50% e familjeve nuk kanë dokumente të duhura pronësore.

- Të konsiderohet rivendosja e popullatës në konsultim dhe negociim me banorët. Vështirësi mund të ketë meqë disa banorë kanë dokumente valide dhe mund të rezistojnë rivendojsen.

Shpresoj që rekomandimet e dala nga kjo punëtori të përkthehen në veprime konkrete në bërjen e këtyre VJF pjesë integruese të qytetit tonë.

Mendoj se shkëmbimi i përvojave mes nesh dhe mësimet e nxjerra nga kjo fushë-punëtori do të jenë ndihmë për komunat tjera në parandalimin dhe zgjedhjen problemeve të vendbanimeve joformale.

### **Pal Lekaj,**

*Kryeshefi i Ekzekutivit të komunës së Gjakovës*



Mitrovicë  
Mitrovica



Peja  
Peja

Gjakovë  
Djakovica



Prishtinë  
Prishtina

Ferizaj  
Urusevac



Prizren



Gjiçan  
Gnjilane

## BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

Për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët, Kosova ka nevojë për qytete më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm përmes planifikimit dhe punës së përbashkët. "Bashkë krijojmë qytete më të mira" është motoja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, financuar nga SIDA, përmes të cilit UN-HABITAT-i do të mbështesë planifikimin komunal hapësinor në Kosovë. Planet duhet të jenë strategjike dhe të orientuara në veprime, detaje në planet rregullative urbane dhe të zbatuara me investime private e publike. Gjashtë qytetet sekondare të Kosovës – Peja, Gjakova, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjiçani – mund të kontribuojnë në një zhvillim më të drejtpeshuar të Kosovës dhe të zvogëlojnë migrimet e vazhdueshme të popullsisë drejt kryeqytetit, Prishtinës. Përmes integritit në rrjetin urban evropian, qytetet dhe qytetarët e Kosovës do të lidhen me qytete tjera evropiane. Kjo mund të arrihet duke tërhequr investimet në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke përmirësuar qasjen për të gjithë. Investimet private janë të nevojshme për t'u kombinuar me ato publike, drejt sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët: banim të përshtatshëm social, spitale, shkolla, transport publik, rrugë, si dhe përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, hapësirat atraktive publike për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie në ndryshim.

## IMPRESSUM



UN-HABITAT



Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal  
në Kosovë

Udhëheqëse e Zyres  
**Elisabeth Belpaire**  
office@unhabitat-kosovo.org

Zyra:  
**UN-HABITAT Kosovë**  
**Rr: Nazim Gafurri, Nr. 33,**  
**10000 Prishtinë, Kosovë**  
Tel:: +381/38/517835  
Fax: +381/38/517836

Informimi & Komunikimi/MP  
**Lumnije Gashi**  
lumnije.gashi@unhabitat-kosovo.org

Për më shumë informata:  
**UN-HABITAT/MuSPP**  
**www.unhabitat-kosovo.org**

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes SIDA-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet i përkasin autorëve. Artikujt pa tregim autori janë pjesë e ekipit të MuSPP-it. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën dhe vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë: Qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklaratave të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e SIDA-s, apo Qeverisë së Suedisë.